	marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, për bashkëpunimin dhe ndihmë të ndërsjellë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera"			është shprehje e vullnetit të përbashkët të dy vendeve tona për të krijuar kuadrin e përgjithshëm të bashkëpunimit në fushën e parandalimit të fatkeqësive, gatishmërisë dhe përgjigjes, si dhe kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës vullnetare ndërmjet palëve në rastin e fatkeqësisë në territorin e secilës prej tyre. Duke qenë se vendet tona ndajnë të njëjtat rreziqe dhe përballen me pothuaj të njëjtat sfida, lidhur me menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, marrëveshja do të forcojë ndë të tjera bashkëpunimin për menaxhimin e fatkeqësive ndërkufitare mes dy shteteve.	bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes civile për të gjitha llojet e fatkeqësive, pra natyrore dhe të shkaktuara nga dora e njeriut, sikurse edhe në të gjitha fazat, pra parandalimit, gatishmërisë, përbalimit dhe riaftësimit. Duke qenë vende kufitare, nëpërmjet bashkëpunimit më të ngushtë midis organizatave homologe dhe institucioneve shkencore do të përmirësohet menaxhimi i fatkeqësive kombëtare dhe atyre ndërkufitare. Ai pritet të ndikojë në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes civile. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, si institucioni i drejtpërdrejtë i interesuar, e vlerëson pozitivisht nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, për faktin se kjo do të ishte në dobi të forcimit të kapaciteteve të dy shteteve në fushën e mbrojtjes civile.			
17	Projekti gj "Për miratimin në parim të "Protokollit të gjashtë shtesë të "Marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore""	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori III	Projektakti është propozuar pasi me kalimin e viteve, modernizimin e kapaciteteve, ndërveprimin në rritje me NATO-n, por edhe vendimeve që janë marrë në kuadër të iniciativës të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM Process), kanë ndodhur shumë ndryshime edhe në mënyrën e funksionimit dhe strukturën e MPFSEE. Këto ndryshime janë dashur të pasqyrohen padyshim në marrëveshjen bazë të krijimit të forcës dhe për këtë janë nevojitur të hartohen dhe të hyjnë në fuqi, përveç protokollit të parë, edhe katër protokolle të tjera	Ky projekt-protokoll ka për synim përmirësimin e marrëveshjes bazë, pasi është gjykuar se nevojitet më shumë fleksibilitet në vendimet që merren, për sa i përket mënyrës sesi funksionon Forca Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) dhe brigada e saj SEEBRIG.	-	-	-
18	Projektvendim "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Polonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes".	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Projektakti është propozuar për të përcaktuar komizat ligjore dhe dispozitat të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet palëve për çështjet e mbrojtjes.	Projektakti parashikon në vija të përgjithshme bashkëpunimin në fushat e operacioneve të kërkim shpëtim, stërvitjet e përbashkëta ushtarake, trajnimin dhe edukimin e personelit civil dhe ushtarak, industrinë e mbrojtjes, shkencën dhe teknologjitë etj..	-	-	-
19	Projektvendim "Për miratimin në parim të "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë mbi masat e shtetit pritës mbi statusin e Organizatës Mbështetëse të Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit dhe personelin e saj".	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori I	Kjo marrëveshje është vijimësi e anëtarësimit të vendit tonë në "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për ngritjen e Task Forcës Mjekësore të Ballkanit", e ratifikuar me ligjin nr. 10/2018.	Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rregullimi i statusit të Organizatës Mbështetëse të Task Forcës Mjekësore të Ballkanit, godinat dhe stafit të saj. Objekti i marrëveshjes është mundësimi i kryerjes së detyrave nga ana e strukturës organizuese të përhershme dhe funksionimi efikas nëpërmjet një drejtimi operacional të kësaj strukturë.	-	-	-
20	Projektvendim "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të shkaktuara nga dora e njeriut"	Ministri i Mbrojtjes	Katërmujori II	Bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë në fushën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të shkaktuara nga dora e njeriut	Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që palët të asistojnë njëra-tjetrën në rritjen e kapaciteteve dhe përgjigjshmërisë ndaj fatkeqësive natyrore apo edhe fatkeqësive të tjera në një kohë kur pala kërkuese nuk arrin të menaxhojë plotësisht pasojat	-	-	-

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Ministria e Kulturës

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministri propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Cështjet kryesore që parashikohen të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
1.	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën"	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Projektakti është parashikuar në programin e Qeverisë 2017-2021, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Kontratën e Performancës ndërmjet Ministrit të Kulturës dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në funksion të mirëmenaxhimit të sistemit kulturor institucional e më gjerë. Synojmë rritjen graduale e në mënyrë të ndjeshme të cilësishë produktit artistik, impaktit artistik, në vend dhe më gjerë. Synojmë gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit në projektet artistike dhe veprimtarive me fokus art kulturë. Riorganizimi i institucioneve të artit dhe kulturës duke krijuar lehtësira në procedurat burokratike të prokurimit për aktivitetet artistike	Ky akt është parashikuar në PIKE 2018-2020(faqe 205), Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	Projektakti është parashikuar në Programin Politik Qeverisës 2017-2021, dhe ka ardhur edhe si nevojë për ndryshim edhe nga kërkesat e institucioneve vendore.	-
2.	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximi	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Krijimi i QKLL bëhet në zbatim të politikave në fushën e librit që kanë për qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e librit dhe leximit.	Ky projektakt sjell krijimin e QKLL si institucion që do të zbatojë strategjitë dhe politikatat e ministrisë në fushën e librit dhe leximit.	-	Po	-
3.	Për mbylljen e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Arbno"i	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Mbyllja e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Arbno"i do të bëhet për shkak të humbjes de facto të funksionit të kësaj qendre	Ky projektakt do të bëjë mbylljen de jure të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Arbno"i	-	-	-
4.	Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme, për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementët themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë dhe gjuhën e tyre	Ministri i Kulturës, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 96, datë 13.10.2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" dhe PKIE	Ky projektakt synon të përcaktojë strategjitë që do të ndërmerren për minimizimin e diskriminimit ndaj pakicave kombëtare dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e tyre	Kapitulli 23	-	-
5.	Për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë	Ministri i Kulturës, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 96, datë 13.10.2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" dhe PKIE	Ky projektakt synon të përcaktojë masat dhe politikatat që do të ndërmerren për minimizimin e diskriminimit ndaj pakicave kombëtare dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e tyre	Kapitulli 23	-	-
6.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28 dhe 30	Ky projektakt rregullon IKTk-në si një institucion i rëndësishëm kombëtar i specializuar shkencor, projektakti do të rregullojë mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe organizimin e saj. IKTk-ja do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. 3. IKTk-ja ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.	-	-	-
7.	Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërbëimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 4, e nenit 197	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor të organit kolegjial Këshilli Kombëtar Muzeve ku përcaktohen rregullat mbi përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërbëimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar Muzeve.	-	-	-
8.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Berat, në fushën	-	-	-

	Kulturore Berat.				e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administron. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.			
9.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28 dhe 32	Ky projektakt rregullon mënyrën e funksionimit dhe organizmit të IKRTK-se si institucion kombëtar i specializuar i trashëgimisë kulturore e cila ka për detyrë regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare. Pranë saj do të krijohen zyrat rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme. KRTK-ja, në funksion të përbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, organet e policisë, institucionet doganore si dhe institucionet ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore.	-	-	-
10.	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616 datë 27.09.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë"	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020	Ky projektakt rregullon ndërhyrjet e kryera në disa nene të rëndësishme të këtij projektligji kanë për qëllim t'i japë një ritëm tjetër dhe një frymë më intensive ecurisë dhe përmirësimit të situatës aktuale të botimeve, përhapjes së librit shqip brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe promovionit të tij në hapësira të ndryshme mediatike, kulturore dhe intelektuale kudo ku gjenerohet dhe ndihet nevoja për literaturën e librit shqip dhe atij të përkthyer.	Ky akt është parashikuar në PIKE 2018-2020(faqe 205), Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"	-	-
11.	Për mënyrën e shpërbërimit të anëtarëve të komisionit këshillimor të ngritur pranë QKVT-së, IKRTK-së dhe IKTK-së për vlerësimin dhe identifikimin e pasurive kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 2, e nenit 59	Ky projektakt rregullon përcaktimin e rregullave për shpërbërimin e anëtarëve të komisioneve këshillimore që do ngrihen pranë QKVT-së, IKRTK-së dhe IKTK-së,	-	-	-
12.	Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërbërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore"	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 2, e nenit 37 dhe neni 40	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor të organit kolegjial Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore ku përcaktohen rregullat mbi përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërbërimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore	-	-	-
13.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Durrës	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Durrës, në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administron. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.	-	-	-
14.	Për Kushtet dhe kriteret e licencimit në kryerjen e veprimtarisë arkeologjike	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 136	Ky projektakt rregullon kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave,	-	-	-

					procedurat për dhënie, pezullimin ose revokimin e licencave si dhe kuotizacioni vjetor i licencave			
15.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Vlorë, në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administro. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.	-	-	-
16.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Gjirokastrë, në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administro. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.	-	-	-
17.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër.	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Shkodër, në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administro. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.	-	-	-
18.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë.	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 28	Ky projektakt rregullon çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së DRTK-së Korçë, në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ajo administro. Gjithashtu rregullon dhe mënyrën e bashkëpunimit me persona juridikë publikë ose privatë.	-	-	-
19.	Për përcaktimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së rjetëzimit.	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 186	Ky projektakt rregullon kushtet që do të kenë kontratat e rjetëzimit, ku do të përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të tyre, si dhe kushtet teknike në rastet e ndërtimit të infrastrukturës përkatëse, ndërtesave dhe zonave të lira të zbulimeve arkeologjike.	-	Po	-
20.	Për miratimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe përcaktimin e masës së shpërbllimit të anëtarëve të tij.	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 37 dhe 39	Ky projektakt rregullon mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërbllimin e KKTJ si organ kolegjal vendimmarrës i përbërë nga 11 anëtarë dhe kryesohet nga ministri.	-	-	-
21.	Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërbllimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 37 dhe neni 38	Ky projektakt rregullon riorganizimin i ri të organit kolegjal të KKTJ, në përshatje me ligjin e ri, duke i dhënë kompetenca të reja sipas këtij organizimi, si dhe përcaktimi për shpërbllimin e anëtarëve në përbërje të tyre.	-	-	-
22.	Për projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"	Ky projektakt rregullon përcaktimin e rregullave, kushteve dhe kriterëve mbi projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe	-	-	-

	kolaudimin e tyre				kolaudimin e ndërhyrjeve ruajtëse në pasuritë kulturore.			
23.	Për emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Në zbatim të nenit 7, të ligjit Nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë", i ndryshuar	Ky projektakt do të përzgjedhë kryetarin e ri të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë pas mbarimit të mandatit të kryetarit aktual.	-	-	-
24.	Për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe negocimit të kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar" si dhe përcaktimin e kriterëve kualifikues dhe vlerësues dhe dokumentacionin e nevojshëm për të këtë procedurë.	Ministri i Kulturës, Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas ligjit nr.37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin negocimin dhe lidhjen e kontratës, me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar" pika 1, e nenit 5	Ky projektakt do të krijojë komisionin që do të vlerësojë kontratën me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar" si dhe do të përcaktojë kriterëve kualifikues dhe vlerësues dhe dokumentacionin e nevojshëm për të këtë procedurë.	-	Po	-
25.	Për kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore. (Tregtia e pasurive kulturore)	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 3, e nenit 116	Ky projektakt plotëson kuadrin ligjor në fushën e licencimit për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore, konkretisht përcaktohen kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe tarifa e kuotizacionit vjetor.	-	-	-
26.	Për kushtet dhe kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave si dhe procedurat për dhënen, pezullimin ose revokimin e licencave, kuotizacionin vjetor të licencave në projektim dhe zbatim të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori I	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" pika 4, e nenit 82	Ky projektakt do të përcaktojë kushtet dhe kriteret e posaçme, dokumentet shoqëruese, nënkategoritë e licencave në fushën e projektimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore.	-	-	-
27.	Për përcaktimin e kufijve të territorit gjeografik të Njërive të Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pikave 1 dhe 9, të nenit 142	Ky projektakt do të përcaktojë kufijtë gjeografikë të Njërive të Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike.	-	-	-
28.	Për përcaktimin e procedurave publike për dhënen në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 171	Ky projektakt rregullon procedurat e konkurimit publik për administrim indirekt të pasurive kulturore nga personat juridikë ose fizikë	-	Po	-
29.	Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe"	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3 e nenit 208	Ky projektakt rregullon funksionimin dhe organizimin e Muzeut Kombëtar të përgjimeve "Shtëpia me gjethe"	-	-	-
30.	Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 133	Ky projektakt rregullon procedurat për hulumtimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të cilat janë ekskluzivitet i institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore ose subjekteve të licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat që hartohen nga institucionet e specializuara shtetërore. Procedura për hulumtimet arkeologjike parashikohet të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të IKTK-së.	-	-	-
31.	Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 82	Ky projektakt do të miratojë mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore që do të përcaktohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me institucionet, entet e tjera publike, universitetet dhe institutet e kërimit të specializuara	-	-	-
32.	Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimin e subjekteve juridike me qëllim vlerësimin dhe rjetëzimin e pasurive kulturore.	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 12	Ky projektakt rregullon çështjet, si mënyrën e funksionimit të subjekteve juridike të themeluara me qëllim vlerësimin dhe rjetëzimin e pasurive kulturore. Gjithashtu përcakton rregulla të detajuara për	-	-	-

					administrimin e pasurive kulturore			
33.	Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen dhe metodologjinë e përgatitjes së planeve të menaxhimit të pasurive të paluajtshme kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 46	Ky projektakt rregullon çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e metodologjisë së përgatitjes, përmbajtjes, strukturës dhe shtrirjes së planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme.	-	Po	-
34.	Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale"	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" nenet 28 dhe 33	Ky projektakt rregullon mënyrën e funksionimit dhe organizimit të QKVT-në si një institucion i specializuar në administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar, në bashkëpunimin me subjekte publike e private	-	-	-
35.	Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1 e nenit 130	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor të krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura.	-	Po	-
36.	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Në zbatim të ligjit nr. 85/76, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë"	Ky projektakt ka për qëllim emërimin në detyrë të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare.	-	-	-
37.	Për procedurat e konkurrimit publik në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike në trashëgiminë kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 90	Ky projektakt synohet të rregullojë çështjet që do të kenë të bëjnë me parashikime, procedura, konkurrime publike për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore, të cilët do të përjashtohen nga zbatimi i parashikimeve të ligjit mbi prokurimin.	-	-	-
38.	Për miratimin e procedurave dhe kritereve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjes e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënie në përdorim të pasurive kulturore.	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", nenet 178 dhe 184	Ky projektakt rregullon në mënyrë të detajuar kushtet dhe procedurat që ndjekin institucionet publike për dhënie në përdorim të pasurive kulturore që kanë në administrim, një subjekti të interesuar nëse garantohet përputhshmëria e qëllimit të përdorimit me destinacionin kulturor të pasurisë dhe dhënie në përdorim nuk cenon vlerat e saj si trashëgimi kulturore. Gjithashtu rregullon dhe procedurat e konkurrimit për dhënie në përdorim të pasurive të paluajtshme kulturore në administrim të institucioneve qendrore ose vendore për qëllim rjetëzimi, për funksione administrative e socialkulturore, me kusht që projekti i rjetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore	-	Po	-
39.	Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqërues, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3 e nenit 139	Ky projektakt rregullon kuadrin ligjor në fushën e lejeve për hulumtime arkeologjike.	-	-	-
40.	Për shpërbëlimin e anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Muzeve	Ministri i Kulturës	Katërmujori II	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 2 e nenit 217	Ky projektvendim rregullon mënyrën e shpërbëimit të anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Muzeve	-	-	-
41.	Projektiligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Marrëveshja e Asociim –Stabilizimit në nenin 73 të saj "Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale", Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020. Direktiva 2012/28/KE, e Parlamentit Evropian dhe Këshilli, datë 25 tetor 2012, "Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor",	Ky projektakt rregullon krijimin e një kuadri ligjor për mundësimin e dixhitalizimit dhe të përhapjes së veprave dhe të materialeve të tjera që mbrohen nga e drejta e autorit ose të drejta të tjera të lidhura me të për të cilat nuk ka mbajtës të të drejtës të identifikuar ose për të cilat mbajtësi i të drejtës edhe kur identifikohet, nuk mund të gjendet - të ashtuquajturat vepra pa autor - përbën një masë themelore të planit dixhital për Evropën. Synohet të zgjidhet problemën konkret të përcaktimit ligjor të statusit të veprës pa autor dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe	Ky akt është parashikuar në PIKE 2018-2020, Kapitulli VII "e Drejta e Pronësisë Intelektuale"	-	-

					përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si vepra pa autor.			
42.	Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura	Ministri i Kulturës, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, e nenit 11	Ky projektakt do të përcaktojë masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në situata jonormale sik; janë fatkeqësitë natyrore dhe konfliktet e armatosura.	-	-	-
43.	Për përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim Ligjor, ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"	Ky projektakt rregullon përkufizimin e tarifës për shpërblim të arsyeshëm, përcaktimin e palëve të cilët do të jenë subjektet që do t'i nënshtrohen aplikimit të tarifës. Përcaktohen pajisjet dhe të gjitha mjetet e tjera që nevojiten për regjistrimin vizual dhe zanor, që bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal. Afatet e pagesës të kësaj tarife, dokumentacioni që importuesit dhe/ose prodhuesit vendas duhet të vendosin në dispozicion të Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autori	-	-	-
44.	Për ushtrimin e funksioneve të fondacionit "Marubi"	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 4, nenit 206	Ky projektakt do të rregullojë kuadrin ligjor të funksionimit të fondacionit "Marubi"	-	-	-
45.	Për përcaktimin e kushteve të posaçme dhe kriteret e licencimit për kryerjen e veprimtarive arkeologjike nënujore dhe monitorimin e tyre.	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pikat 5 dhe 6, të nenit 157	Ky projektakt synon të përcaktojë kushtet dhe kriteret për licencim në kryerjen e veprimtarive arkeologjike nënujore si dhe monitorimin e tyre.	-	-	-
46.	Për përcaktimin e kufijve të Parkut Arkeologjik Durrës	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 1, nenit 212	Ky projektakt do të përcaktojë kufijtë e Parkut Arkeologjik Durrës.	-	-	-
47.	Për miratimin e planit të menaxhimit për Butrintin	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 47	Ky projektakt rregullon miratimin e planit të Parku Kombëtar të Butrintit, në mbështetje të nenit 47, i cili do të përmbajë: objektivat dhe organizimin e menaxhimit, karakteristikat e përgjithshme të territorit të mbrojtur, përfshirjen e partnerëve në zbatimin e planit, sistemin e monitorimit në territorin e mbrojtur dhe sigurimin e masave të shpëtimit në rastet e emergjencave etj.	-	Po	-
48.	Për përcaktimin e rregullave të administrimit të Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 19	Ky projektakt i rëndësishëm rregullon mënyrën e administrimit të "Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore" në formën e një fondi financiar publik, që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale me qëllim sigurimin e ruajtjes së vlerave kulturore materiale	-	-	-
49.	Për përcaktimin e zonave arkeologjike nënujore	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", neni 153	Ky projektakt ka për qëllim përcaktimin e zonave arkeologjike nënujore në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, në Zona A dhe Zona B	-	-	-
50.	Për procedurat e shpalljes publike të pasurive kulturore detare.	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 2, e nenit 154	Ky projektakt ka për qëllim plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e pasurive kulturore detare për sa i përket procedurave të shpalljes publike të këtyre pasurive.	-	-	-
51.	Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore, si dhe të aktiviteteve të tjera që prekin direkt ose indirekt tërësinë e vlerave arkeologjike e historike nënujore.	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", e neni 156	Ky projektakt ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore si dhe aktiviteteve të tjera që prekin direkt ose indirekt këto pasuri.	-	-	-
52.	Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Arteve	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 4, nenit 205	Ky projektakt do të rregullojë kuadrin ligjor të organizimit të Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Arteve të Bukura	-	-	-

	të Bukura.							
53.	Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Ikonave.	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, nenit 207	Ky projektakt do të rregullojë kuadrin ligjor të organizimit të Qendrës së Restaurimit dhe Studimit të Ikonave	-	-	-
54.	Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Bashkëjetesës	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 3, nenit 210	Ky projektakt do të rregullojë kuadrin ligjor të organizimit të Muzeut Kombëtar të Bashkëjetesës	-	-	-
55.	Për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", nenit 96	Ky projektakt rregullon çështje si përcaktimi i zonave mbrojtëse, distancave, masave dhe normave të tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, dritën, kushtet mjedisore dhe peizazhin, për grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme. Masat e miratuara janë drejtpërdrejtë të zbatueshme nga organet kompetente qendrore e vendore në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit dhe pronarët e poseduesit e këtyre pasurive.	-	-	-
56.	Për format dhe llojet e licencave të qarkullimit të lirë për eksportin e pasurive kulturore të luajtshme	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Projektakti është parashikuar në PKIE 2018-2020 (Faqe 191-192)	Ky projektvendim del në zbatim të përafritim që do të bëhet me Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) nr.1081/2012, 9 nëntor 2012 për qëllimet e rregullores së Këshillit (BE) nr. 116/2009 "Mbi eksportin e mallrave kulturore"	Projektakti është detyrim i parashikuar në PKIE	-	-
57.	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025	Ministri i Kulturës	Katërmujori III	Projektakti është parashikuar në PKIE 2018-2020 (Faqe 191-192)	Ky projektakt rregullon çështjet kryesore që janë zbatimi i platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore dhe në sistemin parauniversitar, - fuqizimin e Partneritetit Publik-Privat (PPP) të institucioneve të trashëgimisë kulturore sipas modelit të paraparë në aktet ligjore për trashëgiminë kulturore - ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në nivel qendror, vendor dhe të pavarur - përmirësimin e legjislacionit për mbështetjen e zhvillimit të industrisë kreative si forcë e pa shfrytëzuar sa dhe si duhet deri më tani, - rritjen e buxhetit dhe mbështetjes financiare për artin dhe kulturën, si dhe forcimi i bashkëveprimit të Ministrisë së Kulturës me komunitetin artistik.	Projektakti është detyrim i parashikuar në PKIE2018-2020 (Faqe 191-192)	Qeveria do të përdorë një qasje të re të menaxhimit të institucioneve duke rritur shkallën e pavarësisë së tyre artistike duke krijuar hapësira për gjenërimin e të ardhurave nga burime të treta	-

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministri propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
1	"Për krijimin, mënyrën e organizimit, financimit dhe funksionimit të Institutit Shkencor të Hidrokarbureve"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Zbatimi i ligjit nr. 7736/1993 "Për hidrokarburet", me qellim krijimin e këtij institucioni të caktuar me ligj	Krijimi i institucionit, kompetencat dhe objekti i veprimtarisë	-	-	Strategjia Kombëtare të energjisë
2	Projektligji "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Implementimi i direktivave të BE dhe përcaktimi i kuadrit ligjor për rezervën minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të tyre	Te gjitha çështjet që lidhen me krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	Po	Strategjia Kombëtare të energjisë
3	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 741, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Rregullimi i procedurave për paraqitjen e projektit të rehabilitimit të mjedisit dhe llogaritjen e garancisë së investimit.	Vlerësimi i garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit dhe investimit, për lejet minerare të dhëna sipas ligjit nr. 7796, datë 17.2.2004, "Ligji minerar i Shqipërisë".	-	-	-
4	"Për miratimin e kontratës së koncesionit për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Milot-Balldren"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Miratimi i Kontratës së Koncesionit	Miratimin e kontratës	-	-	-
5	Për miratimin e kontratës së koncesionit për ndërtimin operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Orikum - Dukat	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Miratimi i Kontratës së Koncesionit	Miratimin e kontratës	-	-	-
6	"Për miratimin e rregullores për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për licencimin e audituesit të energjisë dhe shoqërive për shërbime energetike"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Projektakti i jep fuqi zbatuese Ligjit nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".	Ky projektakt rregullon procesin e licencimit të audituesve të energjisë dhe shoqërive për shërbime energetike nëpërmjet përcaktimit të kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale të tyre.	Kapitulli 15 Energjia	-	-
7	Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8569, datë 20.01.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët, të vitit 1995"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Aderimi i Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët, të vitit 1995	Procedurën për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët, të vitit 1995	-	-	-
8	Për miratimin e procedurave, kritereve të konkurrimit dhe afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Përmirësim i procedurave, kritereve të konkurrimit dhe afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese.	Projektvendimi qartëson procedurat konkurruese.	-	-	-
9	Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori I	Derregullimi i kryerjes së aktivitetit minerar nga subjektet profesionale	derregullimi dhe lehtësimi i kryerjes së aktivitetit	-	-	-
10	Për përcaktimin e kritereve të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Saktësim i kritereve të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare.	Përcaktimi i vlerave minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare, vlerave minimale të investimit dhe vlerave minimale të prodhimit për një leje minerare do të bëjnë të mundur mos lejin e copëzimit të trupave minerare, duke ulur në këtë mënyrë rrezikshmërinë e shfrytëzimit të tyre, si dhe do të mundësojnë krijimin e kushteve për përqendrim të kapitalit minerar dhe	-	-	-

					mundësi investimi për teknologji bashkëkohore të vendburimeve minerale.			
11	Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Direktives së BE për çeshtjet e efikasitetit të energjisë	Zbatimi i objektivave që derivojnë nga direktivat e BE për çeshtjet e efikasitetit të energjisë	-	Po	-
12	"Për miratimin e kategorive, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherët e energjisë së konsumatorëve të mëdhenj të energjisë"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Projektakti i jep fuqi zbatuese Ligjit nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".	Ky projektakt rregullon procesin e kualifikimit për menaxherët e energjisë së konsumatorëve të mëdhenj nëpërmjet përcaktimit të kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimit të tyre.	Kapitulli 15 Energjia	-	-
13	Për miratimin e programit të veprimit të Planit 3-vjeçar 2019-2021 për zhvillimin e aktivitetit mineral dhe përcaktimin e zonave minerale të rrezikshme	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Projektvendimi përcakton zonat konkurruese për periudhën 3-vjeçare 2019- 2021.	-	-	-
14	Për rishikimin e planit të veprimit të dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".	Dokumenti prezanton politikën sektoriale për zhvillimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për periudhën afatmesme afatgjatë.	Po	-	-
15	"Për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Ky projektvendim ka qëllim të përputhë kërkesat e Ligjit 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" Neni 6/5, me angazhimet e Qeverisë të shprehura në Planin e 2-të dhe të 3-të Kombëtar për Efikasitetin e Energjisë për Certifikimin e ndërtesave brenda vitit 2018 lidhur me performancën e tyre të energjisë në ndërtesat ekzistuese dhe ato që ndërtohen rishtazi.	Ky projektakt përcakton kërkesat minimale të performancës së energjisë me qëllim që të arrihen nivelet e konsumit energjetik optimal të ndërtesave dhe njësive të ndërtesave.	Kapitulli 15 Energjia	-	-
16	Për miratimin në parim të Marrëveshjes për Shërbimet Ajrore me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Projektakti vjen si rezultat i propozimit të palës britanike për lidhjen e një Marrëveshjeje të re për shërbimet ajrore ndërmjet dy vendeve në kuadër të procesit të daljes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian	Çështje që lidhen me kryerjen e fluturimeve ajrore midis dy vendeve, përcaktimin e rregullave nga secila palë për lëshimin e autorizimeve të operimit për kompanitë ajrore, si dhe për standardet bazë të sigurisë së operimit.	-	-	-
17	Projektligji "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport"	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori II	Përafrimi me direktivën përkatëse të BE.	Rregullon mënyrën e prodhimit, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport. Përcakton kuotat e detyrueshme për përdorim të biokarburanteve	-	Po	-
18	Mbi përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Ligjit nr. 120/2016 për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe RoW.	Kërkesat për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike; Rregulla mbi ndërtimin e infrastrukturës së brendshme me kabull prej bakri dhe fibrë-optike.	-	-	Strategjia Agjenda Digjitale 2015-2020
19	Mbi miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, për ndërtimin e rrjetëve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Ligjit nr. 120/2016 për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe RoW.	Përcaktimi i rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit, për ndërtimin e rrjetëve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.	-	-	Strategjia Agjenda Digjitale 2015-2020
20	Mbi metodologjinë e përcaktimit të çmimit të aksesit dhe të çmimeve referuese	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Ligjit nr. 120/2016 për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe RoW.	Përcaktimi i metodologjisë për përcaktimin e çmimit të aksesit dhe të çmimeve referuese.	-	-	Strategjia Agjenda Digjitale 2015-2020
21	Mbi miratimin e rregullave teknike, për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve dhe njohja e konformitetit të tyre. (transpozimi i direktivës 2014/53/EU). Shfuqizimi i VKM-së Nr. 546, datë 13.6.2013	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori III	Lehtësimi i lëvizjes së lirë të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacionit.	Ky rregull teknik përcakton kërkesat thelbësore në veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të pajisjeve radio në Republikën e Shqipërisë.	-	-	-

22	Për rishikimin e planit të veprimit të dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Implementimi i Ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".	Dokumenti prezanton politikën sektoriale për zhvillimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për periudhën afatmesme afatgjatë.	Po	-	-
----	---	--	-----------------	---	--	----	---	---

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministri propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
